



**Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri**

**Raporti në Këshillin e Përhershëm
Ambasadori Osmo Lipponen, Kryetari i Prezencës
26 shkurt 2004**

Hyrje

Negociatat për përditësimin e mandatit të Prezencës përfunduan me sukses në fund të vitit 2003, duke i dhënë Prezencës një bazë të fortë për vazhdimin e punës së saj në vend. Qëllimi i përgjithshëm i Prezencës në Shqipëri mbetet mbështetja e demokratizimit, shtetit ligjor dhe të drejtave të njeriut. Për të përmbushur këtë qëllim, Prezenca duhet të sigurojë ekspertizë dhe asistencë, veçanërisht në fushën e reformës legislative dhe gjyqësore, ku përfshihen reforma për pronat, reforma territoriale-administrative, reforma zgjedhore, forcimi i kapaciteteve parlamentare, anti-trafikimi dhe anti-korrupsioni, zhvillimi i medias, zhvillimi i shoqërisë civile dhe asistenca për policinë, kryesisht në trainimin e policisë kufitare.

Aspektet specifike të mandatit përputhen me aktivitetet e ndërmarra tashmë nga Prezenca ose të identifikuar si nisma të rëndësishme të së ardhmes. Kjo vjen kryesisht si rezultat i dialogut të ngushtë midis Prezencës dhe qeverisë së Shqipërisë gjatë verës dhe vjeshtës së kaluar, i cili u zhvillua paralelisht me hartimin e programit dhe buxhetit të Prezencës për vitin 2004 për të siguruar vijueshmëri dhe përputhshmëri. Me miratimin e mandatit të ri, Prezenca është marrë me detajimin më specifik të projekteve në mbështetje të temave programatike në përputhje me sugjerimet e delegacioneve, veçanërisht me ato të delegacionit shqiptar, që u paraqitën gjatë diskutimeve për buxhetin.

Siç parashikohej, në mesin e muajit dhjetor, Prezenca mbylli edhe dy zyra rajonale në qytetet e Peshkopisë dhe Elbasanit; tre zyra ishin mbyllur që në fund të vitit 2002. Aktualisht, përveç stafit të zyrës qendrore, mbeten edhe katër zyra rajonale në qytetet Shkodër, Kukës, Vlorë, Gjirokastër, si dhe zyra për Durrësin dhe Tiranën. Aktualisht, Prezenca ka një numër prej 29 punonjësish ndërkombëtarë, nëntë prej të cilëve punojnë në zyrat rajonale dhe 82 punonjës shqiptarë, 8 prej të cilëve janë ngritur në nivelin e ekspertëve (Si pjesë e një procesi të promovimit të stafit shqiptar. “Ekspert” quhet një kategori e veçantë nëpunësish, që bëjnë dallim nga nëpunësit e tjerë dhe pasqyron një kualifikim profesional në një fushë të caktuar).

Raporti i fundit i Prezencës, i paraqitur në Këshillin e Përhershëm në fund të muajit nëntor, u përqendrua gjerësisht në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të zhvilluara sipas një Kodi të ri Zgjedhor, si dhe në kthimin dhe kompensimin e pronave.

Prezenca ka vijuar t'i përkushtojë burime të konsiderueshme këtyre çështjeve, pasi janë zhvilluar disa përsëritje zgjedhjesh, veçanërisht në kryeqytet, më 28 dhjetor 2003, dhe pasi shqyrtimi i projektligjit për kthimin e pronave nga komisionet parlamentare mbeti për të vazhduar pas pushimeve të Vitit të Ri. Gjatë kësaj periudhe, Prezenca përfundoi edhe analizën e saj gjithëpërfshirëse të sistemit ligjor dhe gjyqësor të Shqipërisë dhe filloi të mbështesë Kuvendin në rishikimin e Rregullores së tij.

Që nga raporti i fundit, situata e përgjithshme politike e vendit ka mbetur e brishtë si rezultat i mosfunksionimit të vullnetit politik në lidhje me zgjedhjet e qeverisjes vendore dhe një situatë ekonomike të pafavorshme, që ndikoi në publikun e gjerë dhe biznesin e vogël.

Pakënaqësia publike në rritje dhe opozita gjithmonë e më kundërshtuese, që nisi një sërë protestash kundër qeverisë, e kanë rritur tensionin. Në të njëjtën kohë, një numër procesesh reformash të rëndësishme, që bien brenda sferës së mandatit të Prezencës, janë tashmë në rrugë e sipër dhe do të kërkojnë një marrëveshje të gjerë politike, pavarësisht nga situata aktuale konfrontuese. Prandaj, roli i Prezencës në vazhdim, për të mbështetur dhe lehtësuar këto procese, mbetet tepër i rëndësishëm.

Situata e përgjithshme

Situata politike në Shqipëri një vit pas hapjes së negociatave me Bashkimin Evropian për Marrëveshjen e Asociim-Stabilizimit, duket më e brishtë se më parë. Tashmë, nocioni i konsensusit apo vullnetit politik është harruar në një masë të madhe. Me ardhjen e Vitit të Ri, qeveria e udhëheqësit të Partisë Socialiste Fatos Nano, doli nga një periudhë gjashtë mujore pa ministër të punëve të jashtme dhe një periudhë dy mujore pa ministër të rendit publik. Kjo erdhi pas një ndryshimi të sukseshëm të kabinetit, i cili solli Social Demokratët, partinë politike të tretë për nga madhësia, në "Qeverinë e Koalicionit për Integrit" të shumicës, pasi kjo parti kishte qënë jashtë qeverisë për më se një vit e gjysëm.

Manovrimi me mjeshtëri i zotit Nano për të shmangur një bllokim të mëtejshëm në Kuvend, përse i përket miratimit të ministrave të rinj, që kishte rrezikuar imponimin e një votëbesimi, i dedikohet kryesisht fitores së tij të thellë¹ në kongresin e Partisë Socialiste, që mbahet çdo katër vjet, dhe që këtë radhë u mbajt më 12-13 dhjetor 2003, duke ruajtur pozicionin e tij si kryetar partie. Zhvillimet që çuan në këtë fitore u panë qartë që në përzgjedhjen e kandidatëve socialistë për kryetarë bashkie dhe komune në zgjedhjet e pushtetit vendor, një pjesë e mirë të cilëve u bënë më vonë delegatë në kongres për të rizgjedhur zotin Nano. Ndërsa konferencat e rretheve të PS-së i kishin nxjerrë pothuajse jashtë loje mbështetësit e ish kryeministrit Ilir Meta, ndryshimet në statutin e partisë, të miratuara në kongres, e dobësuan më tej këtë grup brenda strukturave të partisë dhe kërcënuan gjithashtu pozicionet e tyre në grupin parlamentar të Partisë Socialiste në

¹ Zoti Nano fitoi 81% të votave të 566 delegatëve të kongresit; ish Presidenti Rexhep Meidani fitoi 61 vota dhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës Edi Rama 41. Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Gramoz Ruçi raajti pozicionin e tij me një fitore prej 71% kundrejt konkurrentit të tij Petro Koçi, i cili kishte hyrë në garë vetëm dy ditë para kongresit.

Kuvend. Me kundërshtarët e tij të brendshëm tashmë të mënjanuar, zoti Nano rivendosi një kontroll të fortë mbi qeverinë.

Megjithëse në dukje qeveria e kishte zgjidhur pjesën më të madhe të vështirësive të saj më të ngutshme, ajo vazhdon të ballafaqohet me një sërë sfidash. Mëria këmbëngulëse e Partisë Demokratike (PD) në lidhje me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, në veçanti me listat problematike të zgjedhësve, e hodhi opozitën në veprim me një fushatë publike kundër qeverisë. Pakënaqësia në rritje e publikut në lidhje me çështje ekonomike ka detyruar qeverinë të adoptojë politika në përgjigje të opinionit publik, që përbën një zhvillim të ri dhe të mirëpritur. Po kështu, zhgënjimi i grupeve të shoqërisë civile si me politikën e shumicës, ashtu dhe me atë të opozitës, ka dalë së fundi në plan të parë, duke pasur një ndikim të drejtpërdrejtë mbi vendimmarrjen e qeverisë në mënyra të papara deri më sot.

Tragjedia e 9 janarit 2004, në të cilën humbën jetën 21 emigrantë shqiptarë (ende nuk dihet fati i disa të tjerëve), që po kalonin detin në mënyrë të paligjshme për në Itali, është bërë deri tani ngjarja kryesore e vitit. Përveçse shkaktoi një shpërthim emocionesh dhe nxiti solidaritetin kombëtar shqiptar, kjo ngjarje qartësoi shumë prej sfidave, me të cilat përballlet vendi.

Varfëria dhe mjerimi ekonomik, faktorët kryesor që i nxisin njërëzitet të emigrojnë, nuk mund të mos shpërfillëshin më. Padyshim, ato ishin çështje të një shqetësimi të jashtëzakonshëm. Dhe megjithëse trafikimi i paligjshëm i emigrantëve për në Itali përmes Adriatikut pothuajse ishte shuar, arrestimet dhe konfiskimet e bëra gjatë operacionit Rrjeta e Hekurt, nisur si pasojë tragjedisë, treguan se infrastruktura që mbështeste trafiket dhe kontrabandën kishin mbetur të pacënuara, megjithë sukseset e reklamuar të operacioneve të mëparshme si Mirazh 2003². Megjithatë, përparimi i vërtetë në luftën kundër trafikeve, kontrabandës dhe formave të tjera të krimit të organizuar, nuk vjen vetëm duke pretenduar se janë bërë arrestime masive, por duke arritur gjykime të suksesshme dhe duke dhënë dënimet e duhura.

Mbështetja e gjerë e publikut ndaj lëvizjes Mjaft!, e cila reagoi ndaj tragjedisë duke organizuar demonstrime dhe nderje qirinsh, tregoi se ndjenjat e popullit apo shprehja e opinionit publik nuk mund të mbeten monopol i partive politike.

Në të njëjtën kohë, përveç atyre çështjeve ekonomike që preknin emigrantët e paligjshëm, shumica e të cilëve vinin nga pjesa e varfëruar në veri të vendit, dolën të tjera çështje ekonomike, të cilat ndikuan në publikun e gjerë. Kështu, rritjet e propozuara të çmimit të bukës, energjisë dhe shërbimit telefonik, shkaktuan reagime të forta negative, të cilat u kapën nga grupe të shoqërisë civile si Mjaft!, Zyra e Mbrojtjes së Qytetarëve (CAO), sindikatat dhe grupet e biznesit. Qeveria reagoi ndaj suksesit të këtyre fushatave duke ulur disa prej këtyre rritjeve të çmimeve. Tryeza e rumbullakët që Kryeministri zhvilloi

² Mirazh 2003 ishte një operacion rajonal i ndërmarrë nga Iniciativa Bashkëpunuese e Evropës Juglindore (Southeast Europe Co-operative Initiative – SECI) në vjeshtë. Ndër të gjithë anëtarët e SECI-it, Shqipëria u vlerësua për arritjen e numrit më të lartë të arrestimeve.

me OJQ-të kryesore në fund të janarit, dha sinjalin e një ndikimi në rritje të këtyre grupeve, si dhe gatishmërinë e qeverisë për të marrë parasysht mendimet e tyre.

Në përpjekje për të fituar nga kjo pakënaqësi e dukshme publike, opozita nisi fushatën e saj “Nano, ik!”, e cila kishte si qëllim të detyronte Kryeministrin të jepte dorëheqjen dhe të arrinte në zgjedhje parlamentare të parakohshme. Tubimet e protestës të zhvilluara më 7 dhe 21 shkurt tërhoqën mijëra demonstrues. Dhuna e dëshmuar gjatë tubimit të parë, ku pati të shtëna paralajmëruese në ajër nga ana e forcave ruajtëse përpara kryeministrit, nuk u dëshmuar në rastin e dytë, sepse si opozita dhe qeveria dhanë siguri se nuk do ndodhte asnjë incident.

Në tryezat e rumbullakëta të opozitës në kërkim të bashkimit të së djathtës, u mbështetën publikisht një sërë protestash paqësore paralelisht me një rol parlamentar më aktiv në Kuvend. Partia Demokratike ka filluar gjithashtu të përdorë një mënyrë të re për të zgjeruar thirrjen e saj drejtuar grupeve të shoqërisë civile dhe për të tërhequr akademikë dhe intelektualë në mbështetje të zhvillimit të platformës së saj të alternativave. Po kështu, Partia Socialiste ka inaguruar një “kuvendim të madh” për ta vënë veten në kontakt me opinionin publik lokal. Në këtë mënyrë, që të dyja partive kryesore u duhet të ballafaqohen me mungesën e demokracisë së brendshme për të shmangur një gjendje amullie dhe për të nxitur krijimin e një platforme idesh tërheqëse për zgjedhësit. Një faktor kryesor, që do të ndikojë në të, do të jetë hartimi i legjislacionit për financimin e partive politike.

Pavarësisht nga të metat në zhvillimin e zgjedhjeve të 12 tetorit 2003 të përshkruara në *Raportin Përfundimtar* të ODIHR-it, nismat e fundit, si të shumicës ashtu dhe të opozitës, duket se pasqyrojnë mësimet e nxjerra nga shprehja e qartë e vullnetit të zgjedhësve në nivel vendor dhe zërin gjithmonë e më të fuqishëm të organizatave të shoqërisë civile, të cilat ofrojnë ide që nuk përfaqësohen domosdoshmërisht nga vetë partitë. Humbja³ e socialistëve prej afërsisht 15 për qind në rezultatin e përgjithshëm proporcional në shkallë vendi dhe suksesi i kandidatëve të mirëzgjedhur nga PD-ja⁴ për kryetarë bashkie në një numër bashkish, i ka nxitur të dyja partitë të rivlerësojnë strategjitë e tyre duke pasur parasysht zgjedhjet e ardhshme parlamentare të planifikuara për në qershor 2005.

Demokratizimi

Zgjedhjet dhe Reforma Zgjedhore

Megjithëse komuniteti ndërkombëtar dhe vetë autoritetet shqiptare i kushtuan një vëmendje të madhe zgjedhjeve të 12 tetorit 2003 për organet e qeverisjes vendore, si një

³ Krahasuar me rezultatin në shkallë vendi të zgjedhjeve të qeverisjes vendore për vitin 2000. Burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

⁴ Gjatë një fjalimi para Kryesisw së PS-së më 18 shkurt 2004, z.Nano njohu cilësinë e këtyre kryetarëve të bashkive/komunave.

testim për vendin në mes të negociatave me BE-në, *Raporti Përfundimtar*⁵ i ODIHR-it, i dalë rishtas, shpreh se zgjedhjet ishin “një rast i humbur për një përparim domethënës drejt plotësimin të angazhimeve të OSBE-së dhe standarteve të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike.” Megjithëse dy partitë kryesore politike vlerësohen për rolin e tyre në procesin e reformës zgjedhore, ato përsëri kritikohen që nuk arritën “të demonstrojnë një vullnet të mjaftueshëm politik për të siguruar një proces të efektshëm dhe të besueshëm.”

Janë vlerësuar përmirësimet në Kodin Zgjedhor, procesi i ankimimit dhe apelimit, si dhe puna e medias elektronike dhe policisë. Është lavdëruar atmosfera e qetë e vetë fushatës së zgjedhjeve dhe debati i mirëfilltë mes kandidatëve. Megjithatë, lëvrimi me vonesë i fondeve publike për fushatën, gabimet procedurale në plotësimin e tabelave të rezultateve dhe veçanërisht problemet me listat e zgjedhësve janë kritikuar.

Raporti i karakterizon zgjedhjet në Tiranë, të cilat u ripërsëritën më 28 dhjetor 2003, si “të tejzgjatura, konfliktuale, të pasigurta dhe fragmentare”, fjalë që ODIHR-i gjithashtu i përdori për të përshkruar të pesë raundet e votimeve në zgjedhjet parlamentare të 2001. Votimet e përsëritura të Tiranës përbënin raundin më kritik të të gjitha rasteve ku votimet u përsëritën. Në rastin e Tiranës, votimet u përsëritën në 118 qendra votimi, të cilat përfaqësojnë një të tretën e të gjitha qendrave të votimit në kryeqytet. Në zgjedhjet e fundit të pushtetit vendor, të cilat zgjatën deri më 29 janar 2004 (me përsëritjen më të fundit të zgjedhjeve në komunën e Vaut të Dejës), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nuk pati mundësi të shpallte rezultatet përfundimtare në nivel kombëtar para datës 20 shkurt 2004, më shumë se katër muaj pas datës fillestare të zgjedhjeve.

Raporti i ODIHR-it rekomandon ndryshime të shumta në Kodin e ri Zgjedhor për të bërë më të qarta procedurat dhe për të korrigjuar mospërputhjet. Rekomandimi kryesor në këtë drejtim është trajtimi i problemeve domethënëse të lidhura me emërimin e komisionerëve të zgjedhjeve në të gjitha nivelet, duke përfshirë KQZ-në, për tu mbrojtur nga avantazhet politike dhe obstrukcionizmi i qëllimshëm, si dhe për të siguruar komisione të pavarura, të paanshme dhe profesionale. Së shpejti, ODIHR-i dhe Komisioni i Venecias do të nxjerrin një vlerësim të përbashkët për vetë Kodin Zgjedhor, i cili do të japë rekomandime më specifike për ndryshimet në kod.

Çështje kyçe që kërkojnë vëmendje në administrimin e zgjedhjeve janë ato që lidhen me përgatitjen e listave të zgjedhësve, publikimin e hartave të sakta të njësive të votimit dhe zonave zgjedhore, dhënien e udhëzimeve për përmirësimin e procedurave të numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve. Vëmendje i është kushtuar edhe rritjes së pjesëmarrjes së grave në procesin zgjedhor, i cili ka parë një rënie të vazhdueshme të numrit të kandidatëve femra dhe ku praktika e vazhduar e votimit në grupe ose votimit familjar i kanë mohuar grave të drejtën e tyre kushtetuese për të votuar.

⁵ Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve, Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (12 tetor 2003 – 25 janar 2004), Raporti Përfundimtar, Varshavë, 25 shkurt 2004.

Duke pasur parasysh se sa shumë burime i janë përkushtuar punës më shumë se një vjeçare për reformën zgjedhore dhe suksesit të procesit të komisionit dypalësh (bipartizan) në kapërcimin e ankesave dhe polemikave të së shkuarës, është për të ardhur keq që këto zgjedhje nuk arritën rezultatin e dëshiruar përse i përket përmbushjes së standarteve ndërkombëtare. Prandaj, rekomandimet që përmban *Raporti Përfundimtar* duhet të pranohen si një udhërrëfyes për reformën e mëtejshme. Si PS-ja dhe PD-ja janë angazhuar tashmë se do të vazhdojnë procesin e reformës zgjedhore nëpërmjet protokollëve të tyre të përbashkët të firmosur në mbyllje të negociatave për ndryshimet në Kodin Zgjedhor.

Pasi kishin lënë mënjane çështje të rëndësishme në lidhje me sistemin zgjedhor, financimin e fushatave, dhe pasi kishin pranuar se do të nevojitej një vëmendje e mëtejshme për të korrigjuar çdo të metë të hasur në zbatimin e kodit të ri, partitë tashmë kanë planifikuar një proces të ri negociatash në përgatitje për zgjedhjet parlamentare të vitit 2005. Që atëherë, ky angazhim është riafirmuar. Prezenca është e përgatitur të vazhdojë rolin e saj në lehtësimin e procesit politik të nevojshëm për zbatimin e këtyre rekomandimeve më të fundit të ODIHR-it dhe do të fillojë të punojë me partitë politike për të krijuar një mekanizëm të ri të përshtatshëm për negociatat.

Reforma administrative-territoriale

Një fushë tjetër e rëndësishme e reformave që mbart një impakt domethënës politik është reforma territoriale-administrative, e rinisur së fundi nga qeveria pasi ishte shtyrë deri pas përfundimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Kjo reformë parashikon rikonfigurimin e kufijve të brendshëm administrativë të bashkive dhe komunave gjatë tre viteve të ardhshme. Kjo është bërë e nevojshme për shkak të ndryshimeve të brendshme demografike që kanë ndodhur gjatë viteve të fundit dhe për të garantuar një nivel të mjaftueshëm burimesh financiare dhe njërezore për të plotësuar kërkesat e reja ndaj qeverisjes vendore, si rezultat i procesit në zhvillim e sipër të decentralizimit.

Ashtu siç është theksuar në raportet e mëparshme, Prezenca e mbështet një proces transparent dhe konsultativ për rikonfigurimin e kufijve administrativë të hapur ndaj pjesëmarrjes së gjerë politike për të shmangur vendimmarrjen e njëanshme të panevojshme. Në këtë proces, duhet të garantohet gjithashtu edhe roli i Kuvendit.

Kjo reformë e gjerë ndikon mbi një sërë nismash të tjera, si reforma e zyrave të gjendjes civile, të cilat janë tani përgjegjëse për hartimin e regjistrit të ardhshëm të zgjedhësve dhe krijimin e një sistemi adresash, si dhe mbi procesin e kthimit, kompensimit dhe regjistrimit të pronave. Ajo lidhet gjithashtu në mënyrë të drejtpërdrejtë me përcaktimin e kufijve të qendrave të votimit dhe të kufijve të zonave zgjedhore. Duke parë se si kjo reformë është e lidhur me decentralizimin, Prezenca do të donte të shihte një rol më të qartë të prefektëve të emëruar nga qeveria dhe të këshillave të qarkut.

Mbështetja për Parlamentin

Projekti i Prezencës në mbështetje të Kuvendit të Shqipërisë është përqendruar kryesisht në çështje të reformës dhe mbikqyrjes së buxhetit për të rritur rolin e Kuvendit në procesin e hartimit të buxhetit vjetor të shtetit, duke punuar kryesisht me Komisionin Parlamentar për Ekonominë, Financat dhe Privatizimin. Ky bashkëpunim, që ka për qëllim ndryshimin e Ligjit Organik për Buxhetin dhe krijimin e një njësie të re, që do të ishte përgjegjëse për analizën buxhetore, do të vazhdojë gjatë vitit 2004, por do të zgjerohet për të përfshirë mbështetjen që do t'i jepet Komisionit për Mbrojtjen dhe Komisionit për Rendin dhe SHISH përmes një projekti të përbashkët me Qendrën e Gjenezës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF). Do të vazhdojë gjithashtu edhe bashkëpunimi i vendosur më parë me Komisionin për Politikën e Jashtme dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Komisionin për Integrimin Evropian⁶, si dhe Komisionin për Mjetet e Informimit Publik.

Aktualisht, Prezenca është duke punuar për strukturimin e një procesi përfshirës dhe transparent për grupet parlamentare të partive në lidhje me rishikimin e Rregullores së Kuvendit, për të cilën Prezenca është ftuar që të japë ndihmë. Gjithashtu, gjatë këtij viti, do të zbatohet edhe përbërës i projektit i cili forcon marrëdhëniet midis deputetëve dhe zgjedhësve të tyre. Një numër nismash po ndërmerren për të forcuar kapacitetin e stafit administrativ. Në këtë aspekt, Prezenca po zhvillon një *partnership* me Asamblenë e Republikës Portugeze si një mjet për të shkëmbyer përvojë.

Zhvillimi i Medias

Mbështetja për mediat shqiptare mbetet një përparësi për Prezencën. Sektori i medias do të përfitonte nga përmirësimi i aftësive profesionale dhe plotësimi i legjislacionit të pamjaftueshëm dhe përqëndrimi i vëmendjes ndaj institucioneve në zhvillim. Objektivat kryesore të Prezencës gjatë vitit 2004 janë që të punojë për zhvillimin e mëtejshëm të institucioneve dhe legjislacionit shqiptar për median, harmonizimin e standarteve të medias lokale me standartet evropiane, forcimin e medias së pavarur dhe institucioneve të medias, duke kultivuar një liri të përgjegjshme të medias dhe duke mbështetur praktikën e mira gazetareske.

Për të arritur këto objektiva të përgjithshme, Prezenca do të lehtësojë krijimin e një këshilli të qëndrueshëm konsultativ për median, i cili përveç përparësive të tjera, do të rihartojë dhe do të mbështesë zbatimin e Kodit të Etikës për Gazetarët. Gjithashtu, ai parashikohet të ndihmojë komisionin parlamentar për median në përafrimin e legjislacionit shqiptar për median me standartet ndërkombëtare perëndimore, nëpërmjet sigurimit të ekspertizës në procesin e ndryshimit dhe adoptimit të legjislacionit për median, në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias. Mbështetje e vazhdueshme do t'i jepet forcimit të kapaciteteve të Këshillit Kombëtar të Radio-Televizionit (KKRT), duke i dhënë ndihmë këtij organi rregullator në procesin e krijimit dhe zbatimit të Strategji së Zhvillimit dhe Planit të Frekuencave për median elektronike shqiptare në bashkëpunim me Zyrën Evropiane të

⁶ Ky është një komision *ad hoc* për Integrimin Evropian dhe Paktin e Stabilitetit, dhe nuk është një komision i përhershëm.

Radiokomunikacioneve (ERO) dhe IREX-i mbështetur nga USAID. Gjithashtu, Prezenca do të hulumtojë mundësitë për ndërmjetësim në procesin e rikompozimit të KKRT-së.

Zhvillimi i Shoqërisë Civile

Gjatë tre viteve të fundit, është konsoliduar rrjeti kombëtar i Prezencës i Qendrave të Zhvillimit të Shoqërisë Civile (QZhShC) pranë komuniteteve përkatëse dhe gradualisht po zgjerohet gama e shërbimeve që këto qendra i ofrojnë organizatave jo-fitimprurëse dhe grupeve të tjera të shoqërisë civile. Kohët e fundit, Prezenca hapi një qendër të re në Shkodër dhe planifikon të hapë një qendër tjetër në Gjirokastrë. Disa prej këtyre Qendrave për Zhvillimin e Shoqërisë Civile kanë filluar procesin e shndërrimit të tyre në njësi të pavarura financiarisht duke gjeneruar disa të ardhura si konsulentë dhe zbatues projektësh.

Në vitin 2004, Qendrat për Zhvillimin e Shoqërisë Civile do të zgjerojnë bashkëpunimin me qeverisjen vendore dhe do të promovojnë përfshirjen e shoqërisë civile dhe qeverisjen vendore në procesin e planifikimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik-Shoqëror (SKZhES). Gjithashtu, në programet e këtyre qendrave, përfshihen edhe nisma ndërkufitare me Rrjetin Kombëtar për Zhvillim në Kosovë dhe së bashku ato do të paraqesin një platformë për shoqërinë civile në Ballkanin Perëndimor. Prezenca mbështet përfundimin e hartimit dhe zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara së bashku me shoqërinë civile shqiptare dhe institucionet shtetërore.

Ekonomia dhe Mjedisit

Në fushën ekonomike dhe të mjedisit, Prezenca është përqëndruar në një gamë të gjerë projektësh të hartuara rreth temave të anti korrupsionit, sipërmarrjes së të rinjve, zbutjes së varfërisë, forcimit të dialogut qeveri-sipërmarrje dhe ngritjes së ndërgjegjësimit për mjedisin. Aktualisht, Prezenca është duke zbatuar një projekt asistence për Departamentin e Koordinimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave për të ngritur një sistem kompjuterik të bazës së të dhënave. Në 26–27 janar, Prezenca, së bashku me Ministrinë e Financave, organizuan një konferencë rajonale për Njësitë e Informacionit Financiar nga të gjitha vendet e Evropës Juglindore. Në vazhdim të programit të sukseshëm të sipërmarrjes së të rinjve të vitit 2003, seminare të tjera sipërmarrjeje do të organizohen për të fuqizuar rolin e gruas, që do të kenë një komponent të përqëndruar mbi strategjitë e ri-integrimit të viktimave të trafikimit.

Barazia Gjinore

Barazia gjinore do të shërbejë si një temë që do të përshkojë të gjitha projektet e Prezencës. Është ngritur një grup i brendshëm pune për të përcaktuar politikat gjinore brenda Prezencës dhe për të siguruar përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjithë punën e saj. Përsa u përket nismave të veçanta, Prezenca do të mbështesë Komitetin Kombëtar për Mundësi të Barabarta për të krijuar dhe mbështetur një mekanizëm kombëtar për çështjet gjinore, duke hartuar një plan veprimi kombëtar rreth çështjeve gjinore dhe duke rigjallëruar pikat e kontaktit për çështjet gjinore në administratën e bashkive dhe

prefekturave. Prezenca vazhdimisht kërkon të zgjerojë rrjetin e qendrave për këshillimin e grave dhe zyrat e ndihmës ligjore duke hapur qendra të tjera në veri dhe në jug të vendit.

Shteti i së drejtës dhe të drejtat e njeriut

Kthimi dhe kompensimi i pronave

Projektligji për kthimin dhe kompensimin e pronave është tani në fazat e tij përfundimtare të debatit në komisionet parlamentare, përpara se ai të paraqitet për votim në seancë plenare. Komisioni Parlamentar për Ekonominë, Financat dhe Privatizimin dhe Komisioni Parlamentar i Bujqësisë dhe Ushqimit kanë bërë tashmë ndryshimet në tekstin fillestar të propozuar nga Grupi i Ekspertëve Teknikë të udhëhequr nga Prezenca, megjithëse ka mospërputhje midis këtyre dy teksteve. Pasi ligji të miratohet, ish-pronarët do të kenë mundësi të prezantojnë kërkesat e tyre për njohjen, kompensimin dhe kthimin e pronës duke filluar nga data 1 maj 2004. Një fond i veçantë do të krijohet brenda buxhetit të shtetit për një periudhë 10 vjeçare duke filluar nga viti 2005 për të bërë kompensimin eventual, në rast se kthimi fizik i pronës është i pamundur.

Roli drejtues i Prezencës në trajtimin e çështjes së kthimit dhe kompensimit të pronave si nga ana politike ashtu edhe teknike do të vazhdojë në vitin 2004 me qëllimin për të arritur një zgjidhje të qëndrueshme për vendosjen e pronësisë së qartë mbi pronat e paluajtshme. Kjo do të thotë korrigjimi i padrejtësive të së kaluarës përmes një rregullimi të drejtë të çështjeve të të drejtave të pronësisë që kanë dalë nga shpronësimi, shtetëzimi apo konfiskimi, duke ruajtur në të njëjtën kohë stabilitetin shoqëror dhe ekonomik.

Prezenca do të vazhdojë t'i sigurojë asistencë Kuvendit në procesin ligjor të shqyrtimit dhe zbatimit, sapo të miratohet ligji i pronave. Aktivitete të tjera që lidhen me të do të përfshijnë asistencën në hartimin e udhëzimeve dhe akteve nënligjore, ndërtimin e kapaciteteve për institucionet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e ligjit, dhe përhapjen e informacionit publik.

Reforma gjyqësore

Prezenca paraqiti analizën e saj të shumëpritur të sistemit ligjor në Shqipëri, e cila përshkruan kuadrin ligjor, strukturën organizative, aktivitetet dhe sfidat me të cilat përballen institucionet shqipëtare ligjore dhe gjyqësore. Në identifikimin e fushave që kërkojnë vëmendje të mëtejshme, raporti ka për qëllim të ndihmojë zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për reformën institucionale me qëllimin për të forcuar sistemin gjyqësor dhe strukturat e tjera përkatëse.

Gjatë kërkimeve për këtë analizë, u bë e qartë se publiku nuk ka besim tek gjykatat, prokurorët apo tek policia gjyqësore, një situatë që mund të përmirësohet me një transparencë më të madhe. Ekziston gjithashtu një nevojë për të luftuar korrupsionin dhe paaftësinë në sektorë si përmbaruesit, avokatët dhe noterët nëpërmjet mekanizmave më

racionalë të kontrollit dhe zhvillimit të aftësive më të mira. Pas analizimit të aktorëve të ndryshëm në sistemin ligjor, Prezenca ka bërë një sërë rekomandimesh, disa prej të cilave formojnë bazat për një sërë projektesh në këtë fushë.

Të bazuara rreth temës së transparencës, këto projekte të reformës gjyqësore përfshijnë rritjen e pjesëmarrjes së publikut në procesin e hartimit të legjislacionit, rritjen e publikimit të rregullt të vendimeve të gjykatave të apelit dhe gjykatave të niveleve më të ulëta, duke siguruar një ndarje transparente të çështjeve midis gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe duke vendosur mekanizma kontrolli mbi noterët.

Zhvillimi i gjykimit të drejtë

Projekti i Prezencës për zhvillimin e gjykimit të drejtë ka si synim të ndjekë se si gjyqësori plotëson standartet shqiptare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ai përpiket të vlerësojë gjithashtu punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe të sigurojë informacion bazë për aktivitete të mëtejshme të reformës gjyqësore. Në fillim, projekti filloi të ndjekë rastet e sjella para Gjykatës së sapongritur për Krimet e Rënda dhe më vonë do të shtrihet në ndjekjen e rasteve që lidhen me të drejtat e njeriut ose me raste të tjera me rëndësi për zhvillime demokratike.

Mbrojtja e dëshmitarëve

Si pjesë e Task Forcës për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, që përbëhet si nga aktorë ndërkombëtarë ashtu edhe shqiptarë, Prezenca do të vazhdojë të merret me çështje delikate të mbrojtjes së dëshmitarëve deri sa të vendoset një sistem i duhur dhe funksional legjislativ mbrojtjeje. Asistencë do të jepet për zbatimin e legjislacionit të ri sapo ai të miratohet nga Kuvendi. Prezenca parashikon gjithashtu trajnimin e punonjësve socialë të strehësëz qeveritare për këshillimin e viktimave të trafikimit që janë dëshmitarë dhe garanton dhënien e informacionit rreth kuadrit ligjor, procedurave gjyqësore, standarteve dhe kërkesave të mbrojtjes së dëshmitarëve.

Të drejtat e njeriut

Ekziston një nevojë e vazhdueshme për rritjen e standarteve të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe për rritjen e ndërgjegjësimit për konceptet e të drejtave të njeriut. Prej kohësh, Prezenca ka mbështetur punën e Avokatit të Popullit, ose Zyrën e Ombudsman-it dhe do ta vazhdojë këtë bashkëpunim. Kjo zyrë ka funksionuar mirë në përgjigje të shqetësimeve të palëve të prekura. Një përbërës i projekteve të Prezencës për të drejtat e njeriut do të jetë rritja e respektimit të të drejtave të personave të burgosur ose të paraburgosur, duke ndjekur nga afër transferimin e përgjegjësive mbi sistemin e paraburgimit nga Ministria e Rendit Publik tek Ministria e Drejtësisë për të siguruar respektimin e standarteve minimale të trajtimit të këtyre personave. Projekte të tjera në fushën e të drejtave të njeriut në vitin 2004 do të fokusohen tek të drejtat e minoriteteve, veçanërisht tek të drejtat e romëve; të drejtat e punëtorëve; si dhe tek drejtësia për të miturit, si pjesë e Strategjisë Kombëtare për Fëmijëve.

Bashkëpunimi në fushën e sigurimit

Lufta kundër trafikimit

Për t'i dhënë një mbështetje më të mirë Strategjisë Kombëtare të Qeverisë në Luftën kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore si dhe angazhimeve të saj për të luftuar të gjitha llojet e trafikeve, Prezenca do të analizojë nivelin e tanishëm të zbatimit të Strategjisë së bashku me Ministrin e Shtetit përgjegjës për këto çështje për të identifikuar përparësitë. Prezenca është duke zbatuar procedurat e përzgjedhjes së të huajve të ndaluar në Shqipëri duke krijuar kushte për një proces transferimi brenda kontekstit të Memorandumit të Mirëkuptimit të ri të nënshkruar nga Prezenca, IOM, UNHCR dhe ministrinë e rendit publik dhe qeverisjes vendore.

Prezenca po zbaton aktualisht fazën e dytë të projektit për Edukimin me të Drejtat e Grave dhe Anti-Trafikimi, i cili zhvillon trajnime rreth çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, të drejtat e gruas, dhunën në familje dhe trafikimin. Kjo fazë e projektit ka si objekt grupet specifike në rrezik si nxënës të arsimit të mesëm, gratë në zonat rurale dhe romëve, që mund të kenë pak ose aspak akses ndaj këtij lloji informacioni.

Menaxhimi i kufirit

Pas një pune për zgjerimin e modelit të Prezençës për bashkëpunimin kufitar në përputhje me përgjegjësitë e saj sipas Dokumentit të Ecjes Përpara (Way Forward Document), që ishte rezultat i Konferencës së Ohrit, Prezenca do të vlerësojë arritjet e PLANIT Strategjik Të Qeverisë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit për të qartësuar më shumë rolin e saj në të ardhmen në lidhje me çështjet e kufirit së bashku me organizata të tjera partnere.